



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı



01 Nr. 209/26 Dt. 12.05.2026

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## Raporti për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

Ky raport është përgatitur në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643. Për hartimin e tij janë marrë parasysh edhe dispozitat përkatëse që rregullojnë funksionimin dhe përgjegjësitë e nivelit lokal.

Gjithashtu, raporti mbështetet në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, i cili përcakton standardet për transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në të njëjtën kohë, është respektuar edhe Rregullorja Nr. 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, e cila synon të forcojë qasjen në dokumente publike dhe të rrisë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

**Me datë 30.01.2026**, me numër protokolli 01.047/26, kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit. Në përbërje të këtij grupi janë: Muhamet Bajrami (kryesues), Ismal Osmankaj (anëtar), Halil Lika (anëtar), Florentina Çoçaj-Hoti (anëtare), një përfaqësues nga shoqëria civile (EcMa Ndryshe), Haziz Krasniqi (anëtar), Besarta Cakaj (anëtare) dhe Arbër Gashi (anëtar nga KRM “Eko Regjioni”).

**Më datë 05.03.2026**, me numër protokolli 01.098/26, kryetari Shaqir Totaj ka nënshkruar vendimin për plotësim-ndryshim të vendimit paraprak (nr. 01.047/26, datë 30.01.2026), me të cilin është emëruar anëtar i komisionit Arbër Gashi nga KRM “Eko Regjioni”.

Konsultimi publik me qytetarët është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit.

**1-Me date:** 16.02.2026 është mbajtur takimi i parë të pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**2-Me date:** 24.02.2026 është mbajtur takimi i dytë i grupit punues të pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Besarta Caka, Haziz Krasniqi, Iendrit Meleqi, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**3-Me date:** 10.03.2026 është mbajtur takimi i tretë i grupit punues, të pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Besarta Cakaj, Endrit Meleqi, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**4-Me date:** 11.03.2026 është mbajtur takimi i dytë i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Besarta Cakaj, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**5-Me date:** 03.04.2026 është mbajtur takimi i peste i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Endrit Meleqi dhe Muhamet Bajrami.

**6-Me datë:** 04.04.2026 është mbajtur takimi i gjashtë i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Endrit Meleqi, Haziz Krasniqi.

**7-Me datë:** 16.04.2026 është mbajtur takimi i shtatë i grupit punues te pranishëm kanë qenë: Haziz Krasniqi, Arber Gashi, Halil Lika, Muhamet Bajrami dhe Islam Osmankaj.

**8- Me datë 20.04.2026** është mbajtur takimi i tetë i grupit punues, në të cilin kanë qenë të pranishëm: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Arber Gashi dhe Muhamet Bajrami.

#### **Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **27:04.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Fo1Z3Yt2G/>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43021>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetaret-per-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturine-ne-komunen-e-prizrenit/>

**Me 27.04.2026**, njoftimi dhe rregullorja përmes emailit u është dërguar, mediave lokale, OJQ-ve, organizatave, organizatave të studentëve.

**Me 05.05.2026**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultimn-publik-per-projekt-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturine-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Ar4in3m6N/>

Gjithashtu për përmbajtjen e rregullores është përgatitur edhe memorandumi shpjegues, memorandumin mund ta gjeni në këtë vegëz:

<https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Me 06.05.2026, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Procesverbali-per-Projekt-Rregulloren-per-Menaxhimin-e-Mbeturinave-ne-Komunen-e-Prizrenit-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data 27.05.2026 deri me 12.05.2026, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë 12.05.2026.

Përmes formës elektronike në emailat e zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, kanë pranuar 2 koment në formë elektronike, 0 komente përmes platformës së konsultimeve publike, 13 komente janë pranuar gjatë mbajtës së konsultimit publik me qytetarë.

Takimi i fundit i grupit punues është mbajtur me 12.05.2026, ku edhe janë shqyrtuar të gjitha komentet e pranuar.

**Tabelori me të dhëna për komente dhe përgjigje në komente:**

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i qytetarëve që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave
1-Takimi drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit.	05.05.2026 Nga :10:10 Deri: 11:15	F 9 M 28 T 37	15	Pranuar: 14 Pranuar pjesërisht:0 Refuzuar: 0 Adresuar: 3
Është mbajtur konsultim publik	1			

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës:	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1	<p>1.Të eliminohet pika e grumbullimit të mbeturinave në rrugën “Xhavit Bajraktari”, afër ish-konviktit, pasi në këtë lokalitet qytetarët, veçanërisht fëmijët, janë të rrezikuar nga prania e qenve endacakë si pasojë e grumbullimit të mbeturinave.</p>	Ilami Axhillari, Kryetar i Këshillit Lokal “10 Qershori” në Prizren (komente të pranuar në formë elektronike)	Pranuar	<p>Sektori i Mjedisit dhe Mbeturinave vepron sipas Planit Master të sistemit, me qëllim të ofrimit të një shërbimi efikas dhe cilësor. Vendosja e kontejnerëve publikë realizohet sipas sistemit: për shtëpitë private aplikohet sistemi “derë më derë”, për bizneset vendosen kontejnerë të veçantë, ndërsa institucionet duhet të kenë kontejnerët brenda lokacionit të tyre.</p> <p>Jemi të vetëdijshëm se ekzistojnë pika ku krijohen grumbullime të mbeturinave, por ne në vazhdimësi bëjmë pastrimin dhe menaxhimin e tyre.</p>
	<p>2.Të ndalohet grumbullimi i mbeturinave në lagjen Nënkalaja – Pantalia, duke qenë se kjo zonë është e mbrojtur. Kërkojmë nga institucionet përkatëse, përfshirë organet e sigurisë dhe inspektoratin, të ndërmarrin masa për ndalimin e kësaj praktike, e cila ndikon negativisht edhe në imazhin e qytetit, sidomos për vizitorët e Qendrës së Shatërvanit dhe Kalasë së Prizrenit.</p>		Pranuar	<p>Sektori mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave është vazhdimisht i angazhuar në trajtimin e çështjes së mbeturinave në lagjen Nënkalaja – Pantalia, të cilat në disa vende hidhen pa duke marrë parasysh rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të kësaj zone. Në bashkëpunim me inspektoratin dhe organet e sigurisë do të ndërmerrim masa konkrete për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në hapësira jo të përcaktuara.</p> <p>Po ashtu, kompania realizon pastrim të rregullt të kësaj pjese me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe imazhit të qytetit, veçanërisht pasi zona frekuentohet nga vizitorët e Qendrës së Shatërvanit dhe Kalasë së Prizrenit. Por gjithashtu kërkojmë edhe nga qytetarët të bashkëpunojnë në ruajtjen e pastërtisë së hapësirave publike dhe trashëgimisë kulturore</p>
	<p>3.Një kërkesë tjetër nga banorët e lagjes Bylbyldere, konkretisht në rrugën “Anif Muji”, është se, edhe pse rruga është e qasshme për mjetet e vogla për bartjen e</p>		Pranuar	<p>Kompania KRM Ekoregjioni e ka të specifikuar mënyrën e lëvizjes në secilin segment rrugor, ku përfshihet edhe intervali kohor i shërbimit. Kërkojmë nga ju të jeni më specifik</p>

	mbeturinave, punëtorët e kompanisë “Eko-Regjioni” nuk e kryejnë rregullisht këtë shërbim.			dhe të na njoftoni për kohën kur automjetet nuk kanë ardhur sipas orarit të paraparë.  Ne do të ndërmarrim patjetër masa në raste të tilla, pasi të gjitha automjetet janë të pajisura me GPS dhe mund të bëjmë verifikimin e lëvizjeve dhe realizimit të shërbimit në teren.
2	1.Fondet të cilat KRM “Ekoregjioni” do t’i mbledhë nga taksat e qytetarëve nga shërbimi i mbeturinave si do të menaxhohen dhe nga do të shkojnë, a do të përdoren për mjedis apo si do të shfrytëzohen.	Liridona Karjagdiu	Pranuar	Shërbimi do të mbijetojë varësisht nga mjetet e inkasuara dhe kompania duhet të zhvillojë politika për arritjen e nivelit të qëndrueshëm për realizimin e inkasimit. Të gjithë e dimë që komuna nuk ka mundur të realizojë inkasimin e mjaftueshëm, kështu që janë krijuar shumë borxhe, ne do të ishim shumë të kënaqur nëse kompania do ta realizojë këtë arritje. Lidhur me tarifën prej 16.5 €, në rregulloren tonë nuk e kemi këtë tarifë, prandaj ne flasim vetëm për zonën e Komunës së Prizrenit.
3	1-Eshtë një deponi e krijuar në Mushnikovë, kërkoj që ky lokacion të pastrohet dhe të bëhet një investim në mënyrë që të mos përsëritet dukuria e njëjtë. Këtu gjinden mbetje të ngurta nga demolimet dhe të përziera. Po ashtu në Prevallë jeton një shok i imi i cili paguan taksën e mbeturinave 16.5 €/muaj. Kjo taksë përveç që është shumë e lartë, duhet të merret parasysh se ai është banor autokton. Pyetja tjetër është se hapësira publike në Prevallë është hapësirë shumë e uzurpuar, ku duhet të ankohe mi, kush është kompetent për këtë çështje dhe kush duhet të intervenojë.	<b>Almir Bajrami-</b> Bashkësisë Lokale në Mushnikovë	Adresuar	Për ne Prevallë kompetente është Ministria e Mjedisit dhe është zonë krejtësisht e menaxhuar nga Ministria.
4	1.Pyetja ime është çfarë do të ndodhë me borxhet, a do të barten te kompania apo komuna do të zhvillojë procedura për nxjertjen e këtyre borxheve. Mënyra se si i ka shpërndarë komuna faturat është më efektive dhe më e mirë	<b>Bashkim Gashi,</b> përfaqësues i shoqërisë civile	Pranuar	Kompania KRM “Ekoregjioni” veç ka filluar regjistrimin e bizneseve dhe amvisërive dhe këto do të tarifohen që nga periudha kur do të kalojnë inkasimi te kompania. Borxhet nga komuna nuk do të barten te kompania dhe komuna do

	<p>për kompaninë, sepse një faturë është vjetore dhe nuk mund të rritet çmimi në faturë, ndërkaq kompania do ta bëjë faturimin për çdo muaj, derisa mund të veprojë sikurse komuna. Jemi të vetëdijshëm që inkasimi nuk mund të realizohet 100%, por duhet të merret parasysh se komuna duhet të subvencionojë mjete për qëndrueshmërinë e shërbimit, duke u bazuar sipas praktikave nga komunat tjera që kanë probleme shumë të mëdha.</p>			<p>ta shqyrtojë mundësinë se si mund të kemi një procedurë për t'i nxjerrë borxhet nga amvisëritë.</p>
5	<p>1.Sistemi me të cilin kemi punuar shumë me Muhametin dhe të tjerë ka qenë një sistem shembull, prandaj edhe nuk kemi vërejtje, por dua të bëj një pyetje: një pjesë e mbeturinave hidhen në lumë, gjë që ka shkaktuar edhe ngushtimin e shtratit të lumit, siç janë mbeturina të ngurta nga demolimet, dhe ky ngushtim ka shkaktuar ngritjen e ujit nga vërshimet përtej shtratit të lumit. E dimë që uji vjen nga fshati Korishë, dhe në vërshimet e fundit ne kemi pasur shumë probleme. Ne si banorë jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe jemi takuar me KFOR-in gjerman, ku ata na kanë ofruar mbështetje teknike me makineri për pastrim.</p>	<p><b>Simon Veseli</b>- kryetar i këshillit të fshatrave: Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepetnicë, Shpenadi dhe Smaç</p>	Adresuar	<p>Ministria e Mjedisit është kompetente për pastrimin e lumenjve jashtë zonës urbane dhe ankesat duhet të parashtrihen në Drejtorinë e Inspektoratit.</p>
6	<p>1.Kërkoi që mbeturinat në lokacionin afër shoqatës së saj të mos hidhen, pasi aty kemi shumë hedhje nga persona të papërgjegjshëm, por edhe ne si shoqatë shpesh kemi organizuar aktivitete për pastrimin e këtyre lokacioneve, prandaj kërkoj që të investohet në këtë lokacion në mënyrë që të parandalohet hedhja e mbeturinave.</p>	<p><b>Resmije Krasniqi</b>, përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara, "HADER"</p>	Pranuar	<p>Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave vazhdimisht bën eliminimin e pikave ilegale të mbeturinave, por sidoqoftë ne do ta marrim parasysh këtë lokacion dhe do ta shqyrtojmë mundësinë për të realizuar ndonjë investim.</p>
7	<p>1.Kërkoi që të bëhet pastrimi i deponisë ilegale, edhe pse është e rrethuar nga komuna. Një</p>	<p><b>Skënder Elshani</b>- kryetar i këshillit të fshatrave:</p>	Adresuar	<p>Për çdo uzurpim ankesa duhet të bëhet në Drejtorinë e Inspektoratit, ndërsa për hapësirën e gjelbër afër</p>

	shëtitore është krijuar brenda në fshat, por hapësira në mes nuk është e rrafshët, prandaj kërkoj që të investohet në rrafshim dhe gjelbërim. Po ashtu në hyrje të fshatit kemi uzurpim të hapësirave publike.	Piranë, Sërbicë e Poshtme, Medvec dhe Zojz		shëtitores do ta shqyrtojmë si mundësi për të realizuar ndonjë park.
8	1.Ku duhet të ankohet një qytetar nëse kemi hedhje ilegale.	<b>Liridona Karjagdiu</b>	Pranuar	Ankesat e qytetarëve duhet të drejtuar në Drejtorinë e Inspektoratit kjo drejtori ka inspektorin e mjedisit dhe inspektorët komunalë, ku edhe duhet të bëhet ankesa për çdo dukuri që e dëmton mjedisin, në veçanti hedhja e mbeturinave.
	2.Sa gjoba mandatorë janë shqiptuar, ku mundemi ti marrim këto informacione		Pranuar	Sipas raportit vjetor janë prezantuar dy gjoba mandatorë per hudhjen e mbeturinave
9	1.Në hyrje të fshatit është një lokacion shumë i madh ku hidhen shumë mbeturina. Jemi ankuar shumë, nuk po dimë çfarë të bëjmë, edhe fëmijët luajnë aty afër, ku duhet të ankohemi.	<b>Ajet Shala-kryetar i fshatit Atmaxhë</b>	Pranuar	Komuna në vazhdimisi bënë pastrimin e lokacioneve nga hedhja e mbeturinave ilegale, por ende nuk kemi një projekt për krijimin e pikave transferuese, sepse duhet të gjejmë prona publike dhe ato po ashtu duhet të jenë të menaxhuara, për të cilat ekziston problem dhe investimi kërkon shumë.
10	1.Sipas raportit vjetor janë prezantuar dy gjoba mandatorë per hudhjen e mbeturinave	<b>Endrit Melezi-</b> perfaqesues nga OJQ Ec Ma Ndryshe	Pranuar	Ne bëjmë vazhdimisht pastrimin e lokacioneve nga hedhja e mbeturinave ilegale, por ende nuk kemi një projekt për krijimin e pikave transferuese, sepse duhet të gjejmë prona publike dhe ato po ashtu duhet të jenë të menaxhuara, për të cilat ekziston problem dhe investimi kërkon shumë.
11	Në Gjonaj dhe Tupëç, kërkoj që të vendosen kontejnerë te Lapidari, ku qytetarët mund t'i vendosin mbeturinat.	<b>Herolind Osmanollaj-</b> kryetar i këshillit të fshatrave: Gjonaj dhe Tupec	Pranuar	Ne si sektor e kemi një strategji të planifikuar ku vendosja e kontejnerëve bëhet vetëm në vendbanime kolektive, varësisht nga numri i banorëve, ndërsa në amvisëri bëhet shërbimi derë më derë. Vendosja e shportave neve na krijon pika të grumbullimit, të cilat po shfrytëzohen nga amvisëritë për hedhjen e mbeturinave nga shtëpia, prandaj ne po mundohemi të krijojmë një ambient më të menaxhuar dhe më të pastër.
10	1.Në hyrje te fshatit po krijohen mbeturina ku aty po hidhen	<b>Vehbi Shala</b>	Pranuar	Sektori i mjedisit vazhdimisht realizon projekte për vetëdijesim se

	shume mbeturina ne përroin e fshatit, dhe a duhet te ndërmerrni masa qe kjo dukuri te ndalohet.			mbeturinat nuk duhet të hidhen në vende jo përkatëse. Megjithatë, dihet se ka persona të papërgjegjshëm që i hedhin ato në këto vende. Në raste të tilla, është Drejtoria e Inspektoratit ajo që duhet të veprojë dhe të marrë masat e nevojshme.
12	1.Nëse kemi ngritje të tarifës, a do të rritet efikasiteti i shërbimit nga kompania?	<b>Vesa Musaj</b>	Pranuar	Çdo kërkesë për ngritjen e tarifës është e llogaritur sipas analizave të shumta, varësisht nga frekuenca e lëvizjes së automjeteve dhe shpenzimeve të cilat e përcjellin komplet këtë menaxhim. Kjo frekuencë aktualisht është e llogaritur një herë në javë për çdo amvisëri sipas shërbimit derë më derë, ndërsa pikat kolektive të kontejnerëve në banime kolektive pastrohen 2–3 herë në ditë.
13	1.Kërkoi që të realizohet një aplikacion në telefon, ku qytetarët mund të shohin në platformë pikat më të afërta të mbeturinave, sepse sidomos amvisëritë jorezidente apo turistët nuk kanë informacione se ku janë këto pika.	<b>Xhenet Pupuz</b>	Pranuar	Propozimi për krijimin e një aplikacioni për informimin e qytetarëve është i mirëpritur dhe në përputhje me nevojën për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në shërbim. Ne do ta shqyrtojmë këtë mundësi në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, me qëllim që qytetarëve dhe vizitorëve t'u ofrohet informim më i lehtë për lokacionet e shërbimit.
14	1.Në Gornje Lubinje janë krijuar shumë deponi të mbeturinave, prandaj kërkojmë që në këto fshatra të krijohet një lokacion apo pikë transferi ku t'i hedhin mbeturinat për atë zonë.	<b>Halid Karadillami-</b> kryetar i këshillit të fshatrave: Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe Drajqiç	Pranuar	Sa i përket krijimit të pikave transferuese në fshatra si Gornje Lubinje, kjo mbetet një sfidë për shkak të nevojës për sigurimin e pronave publike dhe menaxhimit të tyre. Megjithatë, ne do ta shqyrtojmë këtë kërkesë dhe mundësinë për identifikimin e një lokacioni të përshtatshëm, në mënyrë që të parandalohet krijimi i deponive ilegale dhe të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave në atë zonë.

15	1.Kërkesë për aplikacion për pagesa online po më duket se kenë ngecur mrapa me digjitalizim.Kjo do e përmirësoj dhe lehtësojë inkasimin.	<b>Sait Krasniqi</b> (koment i pranuar në formë elektronike)	Pranuar	Pagesa e shërbimit të mbeturinave mund të realizohet edhe përmes sistemit online. Ju lutemi të vizitoni zyrat tona për të marrë udhëzimet e nevojshme lidhur me çdo mënyrë pagese, në mënyrë që procesi t'ju lehtësohet sa më shumë. Sistemi është mjaft i sofistikuar dhe nuk paraqet pengesa në këtë drejtim.
----	--	---	---------	---

**Shkurtesat:**

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,

Raporti është përgatitur nga :

Laura Suka

Haziz Krasniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



REPUELIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 206/26 Dt. 06.05.2026



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Beledijesi

---

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë  
për Projekt- Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në  
Komunën e Prizrenit**

Me datë 30.01.2026, me numër protokolli 01.047/26, kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit. Në përbërje të këtij grupi janë: Muhamet Bajrami (kryesues), Ismal Osmankaj (anëtar), Halil Lika (anëtar), Florentina Çoçaj-Hoti (anëtare), një përfaqësues nga shoqëria civile (EcMa Ndryshe), Haziz Krasniqi (anëtar), Besarta Cakaj (anëtare) dhe Arbër Gashi (anëtar nga KRM “Eko Regjioni”).

Më datë 05.03.2026, me numër protokolli 01.098/26, kryetari Shaqir Totaj ka nënshkruar vendimin për plotësim-ndryshim të vendimit paraparak (nr. 01.047/26, datë 30.01.2026), me të cilin është emëruar anëtar i komisionit Arbër Gashi nga KRM “Eko Regjioni”.

Konsultimi publik me qytetarët është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit.

Ky grup punues për hartimin e Projekt-Rregullorës për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit ka mbajtur tetë takime, në këto takime janë trajtuar në mënyrë të detajuar çështjet kyçe që lidhen me organizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë grumbullimin, transportin, trajtimin dhe deponimin e tyre. Gjithashtu, është diskutuar harmonizimi i projekt-rregullores me legjislacionin në fuqi dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë këtyre takimeve, anëtarët e grupit punues kanë dhënë kontributet e tyre profesionale për përmirësimin e përmbajtjes së dokumentit, duke adresuar sfidat ekzistuese dhe duke propozuar zgjidhje konkrete për rritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe ndërgjegjësimin qytetar. Si rezultat, është hartuar një draft gjithëpërfshirës që synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe funksional të menaxhimit të mbeturinave në komunë.

### **Takimet e mbajtura të anëtarëve të komisionit:**

**1-Me date:** 16.02.2026 eshte mbajtur takimi i pare te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**2-Me date:** 24.02.2026 eshte mbajtur takimi i dytë i grupit punues te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Besarta Caka, Haziz Krasniqi, Iendrit Meleqi, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**3-Me date:** 10.03.2026 eshte mbajtur takimi i trete i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Besarta Cakaj, Endrit Meleqi, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**4-Me date:** 11.03.2026 eshte mbajtur takimi i dytë i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Besarta Cakaj, Arber Gshi dhe Muhamet Bajrami.

**5-Me date:** 03.04.2026 eshte mbajtur takimi i peste i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Endrit Meleqi dhe Muhamet Bajrami.

**6-Me datë:** 04.04.2026 eshte bajtur takimi i gjashte i grupit punues, te pranishëm kanë qenë: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Endrit Meleqi, Haziz Krasniqi.

**7-Me datë:** 16.04.2026 eshte mbjtur takimi i shtat i grupit punues te pranishëm kanë qenë: Haziz Krasniqi, Arber Gashi, Halil Lika, Muhamet Bajrami dhe Islam Osmankaj.

**8- Me datë 20.04.2026** është mbajtur takimi i tetë i grupit punues, në të cilin kanë qenë të pranishëm: Florentina Cocaj-Hoti, Halil Lika, Haziz Krasniqi, Islam Osmankaj, Arber Gashi dhe Muhamet Bajrami.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **27:04.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Fo1Z3Yt2G/>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43021>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetaret-per-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturiname-ne-komunen-e-prizrenit/>

**Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:10.**

Hapja e konsultimit publik është bërë nga Ymer Berisha, Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes aktive të qytetarëve dhe palëve të interesit në hartimin e Projekt Rregullore për Menaxhimin e Mbeturiname në Komunën e Prizrenit. Ai nënvizoi se ky proces synon të sigurojë transparencë, bashkëpunim dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse, duke i dhënë mundësi komunitetit të kontribuojë me komente dhe sugjerime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së rregullore, në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për menaxhimin e mbeturiname.

Prezantimi i Projekt Rregullore për Menaxhimin e Mbeturiname është bërë nga Muhamet Babjrami, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Menaxhim të Mbeturiname, i cili para të pranishmëve shpalosi përmbajtjen dhe objektivat kryesore të këtij dokumenti. Ai theksoi se rregullorja synon të krijojë një sistem më efikas dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturiname dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, në përputhje me standardet mjedisore dhe praktikat më të mira.

Gjatë prezantimit, Babjrami nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale, operatorëve dhe qytetarëve për zbatimin e suksesshëm të rregullore. Ai ftoi të gjithë

pjesëmarrësit që të japin kontributin e tyre përmes komenteve dhe sugjerimeve konkrete, duke theksuar se konsultimi publik është një hap i rëndësishëm drejt hartimit të një dokumenti gjithëpërfshirës, që i përgjigjet nevojave reale të komunitetit dhe kontribuon në mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Prizrenit.

#### **Komentet e qytetarëve:**

1. **Liridona Karjagdiu**, I takoj sektorit të Mjedisit, pyetja ime është: fondet të cilat KRM “Ekoregjioni” do t’i mbledhë nga taksat e qytetarëve nga shërbimi i mbeturinave si do të menaxhohen dhe nga do të shkojnë, a do të përdoren për mjedis apo si do të shfrytëzohen.
2. **Almir Bajrami**, jam kryetar i Bashkësisë Lokale në Mushnikovë – është një deponi e krijuar në Mushnikovë, kërkoj që ky lokacion të pastrohet dhe të bëhet një investim në mënyrë që të mos përsëritet dukuria e njëjtë. Këtu gjinden mbetje të ngurta nga demolimet dhe të përziera. Po ashtu në Prevallë jeton një shok i imi i cili paguan taksën e mbeturinave 16.5 €/muaj. Kjo taksë përveç që është shumë e lartë, duhet të merret parasysh se ai është banor autokton. Pyetja tjetër është se hapësira publike në Prevallë është hapësirë shumë e uzurpuar, ku duhet të ankohehi, kush është kompetent për këtë çështje dhe kush duhet të intervenojë.
3. **Bashkim Gashi**, përfaqësues i shoqërisë civile – e dimë që shumë amvisëri kanë borxhe, pyetja ime është çfarë do të ndodhë me borxhet, a do të barten te kompania apo komuna do të zhvillojë procedura për nxjerrjen e këtyre borxheve. Mënyra se si i ka shpërndarë komuna faturat është më efektive dhe më e mirë për kompaninë, sepse një faturë është vjetore dhe nuk mund të rritet çmimi në faturë, ndërkaq kompania do ta bëjë faturimin për çdo muaj, derisa mund të veprojë sikurse komuna. Jemi të vetëdijshëm që inkasimi nuk mund të realizohet 100%, por duhet të merret parasysh se komuna duhet të subvencionojë mjete për qëndrueshmërinë e shërbimit, duke u bazuar sipas praktikave nga komunat tjera që kanë probleme shumë të mëdha.
- **Muhamet Bajrami**, udhëheqës i sektorit për mjedis dhe mbeturina – për (1): shërbimi do të mbijetojë varësisht nga mjetet e inkasuara dhe kompania duhet të zhvillojë politika për arritjen e nivelit të qëndrueshëm për realizimin e inkasimit. Të gjithë e dimë që komuna nuk ka mundur të realizojë inkasimin e mjaftueshëm, kështu që janë krijuar shumë borxhe, ne do të ishim shumë të kënaqur nëse kompania do ta realizojë këtë arritje. Lidhur me tarifën prej 16.5 €, në rregulloren tonë nuk e kemi këtë tarifë, prandaj ne flasim vetëm për zonën e Komunës së Prizrenit. Për (2),

për ne Prevallë kompetente është Ministria e Mjedisit dhe është zonë krejtësisht e menaxhuar nga Ministria.

- **Fejsal Hoti**, udhëheqës i Drejtorisë së Shërbimeve Publike – për (3): Kompania KRM “Ekoregjioni” veç ka filluar regjistrimin e bizneseve dhe amvisërive dhe këto do të tarifohen që nga periudha kur do të kalojë inkasomi te kompania. Borxhet nga komuna nuk do të barten te kompania dhe komuna do ta shqyrtojë mundësinë se si mund të kemi një procedurë për t’i nxjerrë borxhet nga amvisëritë.
- 4. **Simon Veseli**, përfaqësues i BL në Velezhë, Menaxhimi i mbeturinave: sistemi me të cilin kemi punuar shumë me Muhametin dhe të tjerë ka qenë një sistem shembull, prandaj edhe nuk kemi vërejtje, por dua të bëj një pyetje: një pjesë e mbeturinave hidhen në lumë, gjë që ka shkaktuar edhe ngushtimin e shtratit të lumit, siç janë mbeturina të ngurta nga demolimet, dhe ky ngushtim ka shkaktuar ngritjen e ujit nga vërshimet përtej shtratit të lumit. E dimë që uji vjen nga fshati Korishë, dhe në vërshimet e fundit ne kemi pasur shumë probleme. Ne si banorë jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe jemi takuar me KFOR-in gjerman, ku ata na kanë ofruar mbështetje teknike me makineri për pastrim.
- 5. **Resmije Krasniqi**, përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara, “HADER”, kërkoi që mbeturinat në lokacionin afër shoqatës së saj të mos hidhen, pasi aty kemi shumë hedhje nga persona të papërgjegjshëm, por edhe ne si shoqatë shpesh kemi organizuar aktivitete për pastrimin e këtyre lokacioneve, prandaj kërkoi që të investohet në këtë lokacion në mënyrë që të parandalohet hedhja e mbeturinave.
- **Muhamet Bajrami**-Ministria e Mjedisit është kompetente për pastrimin e lumenjve jashtë zonës urbane dhe ankesat duhet të parashtrohen në Drejtorinë e Inspektoratit.
- **Muhamet Bajrami**-Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave vazhdimisht bën eliminimin e pikave ilegale të mbeturinave, por sidoqoftë ne do ta marrim parasysht këtë lokacion dhe do ta shqyrtojmë mundësinë për të realizuar ndonjë investim.
- 6. **Skënder Elshani**, kryetar i BL në Pirane dhe Medvec, kërkoi që të bëhet pastrimi i deponisë ilegale, edhe pse është e rrethuar nga komuna. Një shëtitore është krijuar brenda në fshat, por hapësira në mes nuk është e rrafshët, prandaj kërkoi që të investohet në rrafshim dhe gjelbërim. Po ashtu në hyrje të fshatit kemi uzurpim të hapësirave publike.
- **Muhamet Bajrami**-Për çdo uzurpim ankesa duhet të bëhet në Drejtorinë e Inspektoratit, ndërsa për hapësirën e gjelbër afër shëtitores do ta shqyrtojmë si mundësi për të realizuar ndonjë park.

7. **Liridona Karjagdiu** pyet se ku duhet të ankohet një qytetar nëse kemi hedhje ilegale.
- **Muhamet Bajrami**-Drejtorja e Inspektoratit ka inspektorin e mjedisit dhe inspektorët komunalë, ku edhe duhet të bëhet ankesa për çdo dukuri që e dëmton mjedisin, në veçanti hedhja e mbeturinave.
8. **Skënder Elshani**, kryetar i BL në Pirane dhe Medvec, kërkoi që të bëhet pastrimi i deponisë ilegale, edhe pse është e rrethuar nga komuna. Një shëtitore është krijuar brenda në fshat, por hapësira në mes nuk është e rrafshët, prandaj kërkohet që të investohet në rrafshim dhe gjelbërim. Po ashtu në hyrje të fshatit kemi uzurpim të hapësirave publike.
- **Muhamet Bajrami**-Për çdo uzurpim ankesa duhet të bëhet në Drejtorinë e Inspektoratit, ndërsa për hapësirën e gjelbër afër shëtitores do ta shqyrtojmë si mundësi për të realizuar ndonjë park.
9. **Liridona Karjagdiu** pyet se ku duhet të ankohet një qytetar nëse kemi hedhje ilegale.
- **Muhamet Bajrami**-Drejtorja e Inspektoratit ka inspektorin e mjedisit dhe inspektorët komunalë, ku edhe duhet të bëhet ankesa për çdo dukuri që e dëmton mjedisin, në veçanti hedhja e mbeturinave.
10. **Ajet Shala**, përfaqësues i fshatit Atmagje, në hyrje të fshatit është një lokacion shumë i madh ku hidhen shumë mbeturina. Jemi ankuar shumë, nuk po dimë çfarë të bëjmë, edhe fëmijët luajnë aty afër, ku duhet të ankohemi.
- **Muhamet Bajrami**-Ne bëjmë vazhdimisht pastrimin e lokacioneve nga hedhja e mbeturinave ilegale, por ende nuk kemi një projekt për krijimin e pikave transferuese, sepse duhet të gjejmë prona publike dhe ato po ashtu duhet të jenë të menaxhuara, për të cilat ekziston problem dhe investimi kërkon shumë.
10. **Liridona Karjagdiu**, sa gjoba mandatorë janë shqiptuar, ku mundemi ti marrim këto informacione.
11. **Endrit Melezi**, përfaqësues nga OJQ Ec ma ndryshe, - sipas raportit vjetor janë prezantuar dy gjoba mandatorë për hudhjen e mbeturinave
12. **Herolind Osmanollaj**, kryetar i BL në Gjonaj dhe Tupëç, kërkoi që të vendosen kontejnerë të Lapidari, ku qytetarët mund t'i vendosin mbeturinat.
- **Muhamet Bajrami**-Ne si sektor e kemi një strategji të planifikuar ku vendosja e kontejnerëve bëhet vetëm në vendbanime kolektive, varësisht nga numri i banorëve, ndërsa në amvisëri bëhet shërbimi derë më derë. Vendosja e shportave neve na krijon pika të grumbullimit, të cilat po

shfrytëzohen nga amvisëritë për hedhjen e mbeturinave nga shtëpia, prandaj ne po mundohemi të krijojmë një ambient më të menaxhuar dhe më të pastër.

13. **Vehbi Shala**, përfaqësues nga fshati Poslisht – tha se ne hyrje te fshatit po krijohen mbeturina ku aty po hidhen shume mbeturina ne përroin e fshatit, dhe a duhet te ndërmermi masa qe kjo dukuri te ndalohet.
14. **Vesa Musaj**, jam e diplomuar për mjedis: nëse kemi ngritje të tarifës, a do të rritet efikasiteti i shërbimit nga kompania?
  - **Muhamet Bajrami**-Çdo kërkesë për ngritjen e tarifës është e llogaritur sipas analizave të shumta, varësisht nga frekuenca e lëvizjes së automjeteve dhe shpenzimeve të cilat e përcjellin komplet këtë menaxhim. Kjo frekuencë aktualisht është e llogaritur një herë në javë për çdo amvisëri sipas shërbimit derë më derë, ndërsa pikat kolektive të kontejnerëve në banime kolektive pastrohen 2–3 herë në ditë.
15. **Xhenet Pupuz** kërkoi që të realizohet një aplikacion në telefon, ku qytetarët mund të shohin në platformë pikat më të afërta të mbeturinave, sepse sidomos amvisëritë jorezidente apo turistët nuk kanë informacione se ku janë këto pika.
16. **Halid Karadillami**, në Gornje Lubinje janë krijuar shumë deponi të mbeturinave, prandaj kërkojmë që në këto fshatra të krijohet një lokacion apo pikë transferi ku t’i hedhin mbeturinat për atë zonë.
  - **Muhamet Bajrami**-Propozimi për krijimin e një aplikacioni për informimin e qytetarëve është i mirëpritur dhe në përputhje me nevojën për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në shërbim. Ne do ta shqyrtojmë këtë mundësi në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, me qëllim që qytetarëve dhe vizitorëve t’u ofrohet informim më i lehtë për lokacionet e shërbimit.
  - **Muhamet Bajrami**-Sa i përket krijimit të pikave transferuese në fshatra si Gornje Lubinje, kjo mbetet një sfidë për shkak të nevojës për sigurimin e pronave publike dhe menaxhimit të tyre. Megjithatë, ne do ta shqyrtojmë këtë kërkesë dhe mundësinë për identifikimin e një lokacioni të përshtatshëm, në mënyrë që të parandalohet krijimi i deponive ilegale dhe të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave në atë zonë.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 11:15.**

**Me 05.05.2026**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultimn-publik-per-projekt-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-komunen-e-prizrenit/>


Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Ar4in3m6N/>

**Procesmbajtës:**

Laura Suka

Haziz Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Председник Општине  
Belediye Başkanı

01 Nr. 098/26 Dt. 05.03.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit 01 nr. 047/26, të datës 30.01.2026, që ka të bëjë me formimin dhe emërimin e Grupi Punues për hartimin e Draft Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, e cila është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (KPZ) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 001-011-38749, datë 10.03.2022, kështu që, në vend të Besarta Cakaj, e emëruar si në pikën 1.7 të vendimit bazik, emërohet Arbër Gashi nga KRM "Eko Regjioni".
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01 nr. 047/26, të datës 30.01.2026, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohet Kryesuesi i Grupit Punues dhe të lartcekurit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
  - Kryesuesit të Grupit Punues,
  - Të lartcekurve,
  - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 047/26 Dt. 30.01.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:


### V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Draft Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullore nr. 01/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, e cila është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (KPZ) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore nr. 001-011-38749, datë 10.03.2022. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
  - 1.1. Muhamet Bajrami ..... kryesues,
  - 1.2. Islam Osmankaj ..... anëtar,
  - 1.3. Halil Likaj .....anëtar,
  - 1.4. Florentina Çoçaj Hoti,..... anëtare,
  - 1.5. OJQ "Ec Ma Ndryshe".....anëtar,
  - 1.6. Haziz Krasniqi, .....anëtar,
  - 1.7. Besarta Cakaj,.....anëtare.
2. Detyrat e Grupit Punues, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartojë Draft Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullore nr. 01/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, e cila është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (KPZ) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore nr. 001-011-38749, datë 10.03.2022, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të draftit përkatës, ta procedojë atë në organet kompetente për shqyrtim dhe miratim.
2. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Të emëruarve,
  - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj





## NJOFTIM PUBLIK

**Komuna e Prizrenit fton qytetarët në konsultim publik për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave.**

**Data : 05.05.2026**

**Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë)**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

**Ora : 10:00**

01 Nr. 178/26 Dt. 27.04.2026

**Të dashur qytetarë/e,**

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe Rregulloren 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, lëshon këtë:

### NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **27.04.2026** deri me datën: **12.05.2026** ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **05.05.2026**, në sallën e Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë), me fillim në ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **12.05.2026** në ora **10:00**, në emailat e zyrtarëve: [Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net](mailto:Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net), [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) dhe [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net), si dhe në formë fizike në këtë adresë: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë).

Për më shumë detaje për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=rregullore-ne-konsultim-publik>

Platformën për Konsultime Publike: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>

Memorandumi shpjegues për rregulloren: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Ymer Berisha

për:

Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun



## JAVNO OBAVEŠTENJE

**Komuna e Prizrenit fton  
qytetarët në konsultim publik  
për Projekt-Rregulloren për  
Menaxhimin e Mbeturinave.**

**Dana: 05.05.2026**

**Mesto: Sala za sednice**

**Skupštine Opštine (Bela**

**Kuća)**

**Vreme: 10:00**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURİYETİ  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01  
Nr. 178/26 Dt. 27.04.2026



**Poštovani građani,**

Opština Prizren je preko radne grupe za izradu Pravilnika za Menadžiranje Otpada u Opštini Prizren, na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren, br. 01/011-5643, Administrativnog uputstva (MALS) br. 04/2023 za Otvorenu Administraciju u Opštinama i Pravilnika 01/2025 za Transparentnost u Opštini Prizren, daje ovo:

### JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javnih konsultacija sa građanima za Projekt Pravilnik za Menadžiranje Otpada u Opštini Prizren

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **27.05.2026** do datuma: **12.05.2026** dok će se javna konsultacija sa građanima održati **05.05.2026**, u sali za sednice Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **10:00 h**.

Vaše komentare i sugestije možete slati do datuma **12.05.2026** u **10:00**, na e mail službenika: [Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net](mailto:Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net), [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) i [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net), kao i u fizičkoj formi na ovoj adresi: ulica Adem Jashari br. 275 Prizren, 20000 (Bela Kuća).

Za više detalja o Projekt Pravilniku za Menadžiranje Otpada u Opštini Prizren, možete posetiti linkove:

Službeni portal u rubrici planovi na javnoj konsultaciji: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=rregulloret-ne-konsultim-publik>

Platforma za javne konsultacije: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>

Memorandum objašnjenja za Pravilnik: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Ymer Berisha  
për:   
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću



## KAMU BİLDİRİSİ

**Prizren Belediyesine Atık Yönetimi Yönetmelik Taslağı ile ilgili kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediye sakinlerine duyurulur.**

**Tarih : 05.05.2026**

**Yer: Belediye Meclis toplantı salonu (Beyaz Ev)**

**Saat : 10:00**

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURİYETİ  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 178/26 Dt. 27.04.2026

**Sevgili vatandaşlar,**

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü ve Prizren Belediyesinde Şeffaflıkla ilgili 01/2025 sayılı Yönetmeliği ile Belediyelerde Açık Yönetim için 04/2023 sayılı İdari Talimat (YYİB) gereğince Prizren Belediyesinde Atık Yönetimi Yönetmeliğın tasarlanması için çalışma grubu aracılığıyla işbu duyuruyu sunmaktadır:

Prizren Belediyesinde Atık Yönetimi Yönetmelik Taslağı ile ilgili kamu istişarenin düzenlenmesi için

### KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **27.04.2026 - 12.05.2026** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **05.05.2026** tarihinde Belediye icra binasının üçüncü katında – Belediye Yönetim salonunda saat 10:00 da başlamak üzere düzenlenecektir

Yorum ve önerilerinizi **12.05.2026** tarihinde saat **10:00** kadar: [Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net](mailto:Muhamet.i.Bajrami@rks-gov.net) , [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) ve [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net) yetkililerin e – posta adreslerine iletebilir ya da Adem Jashari caddesi No. 275 Prizren 20000 (Beyaz Ev) adresine teslim edebilirsiniz.

Prizren Belediyesinde Atık Yönetimi Yönetmelik Taslağı ile ilgili daha fazla bilgi için aşağıdaki siteleri ziyaret edebilirsiniz: Resmi web sitenin kamu istişare yönetmelikler kısmında: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=rregulloret-ne-konsultim-publik>

Kamu İstişare Platformu: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>

Yönetmelik için açıklayıcı iyi niyet sözleşmesi: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Ymer Berisha  
Për:   
Halkla İletişim Birim Yöneticisi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së konsultimit: **05.05.2026.**

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	MUHAMET BAJRISAI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
2	Jamir Jula	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
3	Agon Ukimeraj	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
4	ARBEL HASLIZI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
5	AGRON HALIMAJ	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
6	AJET SHALA	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
7	VESA MUSA	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
8	Endrit Meleqi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
9	Resmije Krasniqi	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
10	ARMIR BASRAMI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së konsultimit: **05.05.2026.**

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	MAHIR SHISHKO	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
2	Ilirij Arhillon	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
3	HERJIND OSMANOLLAJ	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
4	DASHKOR VECU	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
5	BEDEI SHALA	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
6	Simon Veseli	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
7	Sifet Solrji	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
8	SAMIL PIRECI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
9	GALP DZELALHA	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
10	ELUP ICRYESU	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së konsultimit: **05.05.2026.**

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	Smajl Lutfemid	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
2	SELDER OSMANAJ	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
3	MEHRENE KRASHI	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
4	Adelina Hoqaj	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
5	HEBIJ SHALA	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
6	ZETIK KRASHI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
7	MEHDI CIBO	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
8	FERIM SHALA	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
9	URIM MOLIARU	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
10	HANIJ BILUPAJ	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së konsultimit: **05.05.2026.**

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	HAUD KARADOCANI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
2	BEKIM THACI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
3	AKHILDEJ / BRALIMU	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
4	Cennet Ripus Potori	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
5	HASAN HOTI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
6	Beresta Hajri	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
7	Hyrirete Kosova	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
8					
9					
10					